

**VENDIM**  
**Nr. 93/2017**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS  
DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT  
TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të neneve 18, pika 1, dhe 29 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Struktura organizative e personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 29.9.2017

*Lidhja nr. 1*

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONIT  
TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

<b>Funksioni organik</b>	<b>Klasifikimi i pagës</b>	<b>Numri (2)</b>
<b>I. KRYETAR</b>	G3*	1
Sekretar	Sekretar në kabinetin e Kryetarit të Kuvendit**	1
<b>II. KOMISIONERËT</b>	G3*	<b>(11)</b>
<b>III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR</b>		<b>(16)</b>
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	12
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	4
<b>IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM</b>	I-a	1
<b>V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN</b>		<b>(12)</b>
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-a	4
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-b	2
Përkthyes	II-b	3
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1

Specialist pritje me popullin	IV-b	1
<b>VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>		<b>(8)</b>
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT	III-b	1
Specialist protokoll/arkiv	IV-b	1
Magaznier	VII	1
Punonjës pastrimi	III	1
Shofer	V	1
<b>Gjithsej</b>		<b>50</b>

*Shënim:*

*\*Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

*\*\*Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit është sipas VKM-së nr. 187/2017.*

**Strukturë organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

